



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I MINISTRAVE  
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M


Nr. 04, datë 14.12.2022

**PËR**  
**MIRATIMIN E RISHIKIMIT TË PLANIT TË PËRGJITHSHËM VENDOR BASHKIA**  
**DIMAL, TË MIRATUAR ME VENDIMIN NR.3, DATË 08.02.2017**  
**TË KËSHILLIT KOMBËTAR TË TERRITORIT**

Në mbështetje të neneve 7, 20, 25 dhe 26 të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar, të neneve 11 dhe 12 të Vendimit Nr. 686, datë 22.11.2017 të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit”, të ndryshuar, të Vendimit Nr. 519, datë 20.09.2017 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, i ndryshuar, të Vendimit Nr.3, datë 08.02.2017 të KKT-së “Për miratimin e Planit të Përgjithshëm Vendor, Bashkia Dimal”, me propozim të Kryetarit të Bashkisë Dimal, si dhe referuar Vendimit të Këshillit të Bashkisë Nr. 70 datë 21.11.2022, Këshilli Kombëtar i Territorit,

**VENDOSI:**

1. Në Planin e Përgjithshëm Vendor Bashkia Dimal, të miratuar me Vendimin Nr.3, datë 08.02.2017, të Këshillit Kombëtar të Territorit, të bëhen ndryshime në dokumentin e:
  - *Rregullores së Planit:*
    - Kudo ku citohet emri “*Bashkia Ura Vajguore*”, zëvendësohet me emrin “*Bashkia Dimal*”;
    - Pas pikës 1.5.3 “*Përdorimet që lejohen, ndalohen apo kushtëzohen, përfshirë kushtet përkatëse*”, shtohen pikat:
      - 1.5.3/1 “*Rastet për të cilat hartimi i PDV-së nuk është i detyrueshëm dhe/ose i nevojshëm*”;
      - 1.5.3/2 “*Varrezat*” ;
      - 1.5.3/3 “*Rregullat për zhvillimet në sistemet Urban, Bujqësor dhe Natyror*”.
    - Pika 1.5.4 “*Dispozitat e përgjithshme*” ndryshohet;
    - Pas pikës 1.5.4 “*Dispozitat e përgjithshme*”, shtohet pika 1.5.4/1 “*Zhvillimet ekzistuese në sistemet Bujqësor dhe Natyror*”;




Pas pikës 1.7.1 “Përcaktimi dhe përshkrimi i kategorive rrugore”, shtohet pika 1.7.1/1 “Kufizimi i ndërtimeve përgjatë rrugëve të kategorive A, B dhe C”;

- Pika 1.8.3 “Përcaktimi i zonave mbrojtëse përgjatë baseneve ujore (vija blu)”, ndryshohet;
- Pas pikës 1.8.3 “Përcaktimi i zonave mbrojtëse përgjatë baseneve ujore (vija blu)”, shtohet pika 1.8.3/1 “Kanalet vaditëse/Emisaret” dhe pika 1.8.3/2 “Rregulla mbi përdorimin e burimeve ujore”;

- Tabelat e treguesve të zhvillimit të njësisve strukturore;

sipas Dokumentit të Rishikimit të Planit të Përgjithshëm Vendor Bashkia Dimal, bashkëlidhur këtij Vendimi.

2. Ngarkohen Bashkia Dimal dhe Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit për botimin e Vendimit dhe dokumentit shoqërues të tij, në Regjistrin Kombëtar të Planifikimit të Territorit, si dhe për përditësimin e informacionit GIS dhe platformës e-Harta, sipas ndryshimeve të miratuara.
3. Ngarkohen Bashkia Dimal, Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit, si dhe autoritetet përgjegjëse për planifikimin dhe zhvillimin e territorit për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.



**KRYETARI**  
**EDI RAMA**

MINISTËR I LINJËS  
MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË  
BELINDA BALLUKI



ANËTAR / SEKRETAR I KKT  
DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT  
LEDIA TOTA

